



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:169274

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05377855

P.nr.2401/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e çështjes Laura Hoti Statovci duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër Nd.37/24 të datës 24.10.2023, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.700/20 e datës 03.12.2020, kundër të akuzuarit B. B. dhe I. G., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par 1 dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 të KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 të KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), Gjykata më datën 26.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** APROVOHET marrëveshja nr. Nd.37/24 të datës 24.10.2023, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarit B. B. dhe I.G..
- II.** HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.700/20 e datës 03.12.2020 dhe,
- III.** PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarve B. B. dhe I. G. pasi të njëjtit kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën PP.II.nr.700/20 e datës 03.12.2020, ka ngritur aktakuzë kundër të akuzuarit B. B. dhe I. G., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par 1 dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 11.12.2023 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me akordimin e palëve në procedurë e duke vepruar konform nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datë 16.02.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.37/24 të datës 24.10.2023 në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 16.02.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të KPPRK-së lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.2401/20 më datë 27.02.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Laura Hoti Statovci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe e njëjta do ta ketë Fuqinë e titullit ekzekutiv.